



01-356

	<p><b>Republika e Kosovës</b> Republika Kosova-Republic of Kosovo</p> <p><b>Komuna e Prishtinës</b> Opština Priština-Municipality of Prishtina</p>	
---	--	---

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-03 dt.21.06.2016, nenit 17, pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, dhe në bazë të kërkesës 05 Nr. 350/02-32235/24 dt.04.03.2024, të kërkuesve Driton Qehaja dhe Selvete Shuleta Qehaja nga Prishtina, me adresë Rr. Simon Shiroka, 30D/7, për ndërtimin e shtëpisë individuale, në kuadër të Parcelës ndërtimore: “L-10-14”, të Bllokut urban “L-10” të Tërësisë “L”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 17.12.2024, merr këtë:

## V E N D I M

### PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

**I. I CAKTOHEN KUSHTET NDËRTIMORE** pronarëve Driton Qehaja dhe Selvete Shuleta Qehaja nga Prishtina, me adresë Rr. Simon Shiroka, 30D/7, sipas kërkesës 05 Nr. 350/02-32235/24 dt.04.03.2024, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin ideor për ndërtimin e shtëpisë individuale me etazhitet B+P+1, në kuadër të Parcelës ndërtimore: “L-10-14”, të Bllokut urban “L-10” të Tërësisë “L”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim” në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 02044-1 , ZK Çagllavicë.

**II. Lokacioni** i parcelës për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, përfshihet në kuadër të Parcelës ndërtimore: “L-10-14”, të Bllokut urban “L-10” të Tërësisë “L”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim” në Prishtinë, miratuar me Vendimin e Komunës së Prishtinës, 01 Nr. 35-186850 dt.02.10.2013, ku sipas këtij plani kjo zonë është paraparë të jetë me destinim rezidencial për banim individual. Pronari, me shkresën – Informim nga Plani Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim” me referencë 01 Nr. 350/01-99897/23 dt.06.06.2023, lëshuar nga drejtoria e Planifikimit Strategjik e Komunës së Prishtinës, përmes qendrës për shërbim me qytetarë, janë informuar për kriteret, parametrat urban dhe kushtet e ndërtimit për atë zonë.

**III. Gjendja ekzistuese** e lokacionit/parcelës të lartcekur sipas gjendjes, kadastrale, pronësore, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor është:

- Numri, sipërfaqja, pronari dhe klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, janë:
- Nr.02044-1.....S=541 m<sup>2</sup>..... Driton dhe Selvete Shuleta Qehaja.....”arë e klasës 3”;
- E drejta pronësore – juridike e parcelës të lartcekur, është private, në bazë të kopjes së planit dhe certifikatës së njësisë kadastrale;
- Në kuadër të parcelës kadastrale nr. 02044-1,ZK. Çagllavicë, nuk ka ndërtesë të ndërtuar;
- Terreni ka pjerrtësi / disnivel nga drejtimi lindje – perëndim, me disnivel ~ 1.0 m’;
- Qasja ekzistuese në parcelë kadastrale të lartshënuar, është nga rruga ekzistuese “Zef Serembe”, e cila njëherit është edhe rrugë e planifikuar e planit rregullues;
- Në hapësirën e përfshirë në diametër prej 50 m’ ka ndërtesa individuale të banimit/shtëpi;



**IV. Kushtet Ndërtimore** për hartimin e dokumentacionit ndërtimore/projektit kryesor për rregullimin e hapësirës sipas gjendjes së planifikuar në kuadër të Parcelës ndërtimore: “L-10-14”, të Bllokut urban “L-10” të Tërësisë “L”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim” në Prishtinë, përcaktohen bazuar në parametrat, kriteret urbane, kushtet për ndërtim për realizimin – ndërtimin e shtëpisë individuale, dhe hapësira përcjellëse janë:

- Organizimi me qasje në kuadër të parcelës kadastrale, pozicionimit, gabariti dhe etazhiteti i ndërtesës, në raport me vijën rregulluese dhe atë ndërtimore, distanca e ndërtesës nga kufiri i parcelave, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në plani i lokacionit, bashkangjitur këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore;
- Parcela kadastrale, me sipërfaqe të trajtuar në kuadër të parcelës ndërtimore “L-10-14”, të Bllokut urban “L-10”, për realizimin e shtëpisë individuale B+P+1 që përfshihet në ndërtim – parcelë ndërtimore, konkretisht parcela kadastrale e trajtuar Brenda vijës rregulluese, është:
  - Nr. 02044-2, ZK. Çagllavicë ..... $S=541\text{ m}^2$ ;
- Pjesa e parcelës kadastrale nr. 02044-2, ZK. Çagllavicë me sipërfaqe  $S=59\text{ m}^2$ , e cila shtrihet në hapësirë të planifikuar për interes publik (rrugë), është ndarë për të profilizuar rrugën, mirëpo e njëjta mbetet të trajtohet në fazat tjera të zhvillimit;
- Me këto kushte ndërtimore në kuadër të parcelës ndërtimore “L-10-14”, të Bllokut urban “L-10” të Tërësisë “L”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim” në Prishtinë, planifikohet të ndërtohet shtëpi individuale me sipërfaqe ndërtimore dhe etazhitet, sipas kalkulimeve dhe projekt propozimit, si në vijim:
  - Ndërtesa – Shtëpi individuale me  $S=369.21\text{ m}^2$  / sipërfaqe totale,  $S=252.21\text{ m}^2$  /mbi tokë;  $S=252.21\text{ m}^2$  /nën tokë
  - Etazhiteti **B+P+1**;
- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës ndërtimore – brenda vijës rregulluese (ISHP), për vendosjen e shtëpisë individuale, sipas Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim” është max. 40%,  
 $S=541\text{ m}^2 * 0.4 = 216.40\text{ m}^2$ , i lejuar’  
 $S=126.73.72\text{ m}^2$ - i projektuar;
- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës ndërtimore për nëntokë (ISHN), për bodrumin e shtëpisë ,sipas Planit është max.60%;  $S=541\text{ m}^2 * 0.6 = 324.6\text{ m}^2$ ,  
 $S=117.0\text{ m}^2$ - e propozuar;
- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës ndërtimore për sipërfaqet gjelbëruese (ISHGJ), me gjelbërim të lartë dhe të ultë, sipas pikës II të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt.14.08.2016 dhe protokolluar me numrin 04 nr. 031-185481, është 40%;  
 $S=541\text{ m}^2 * 0.4 = 216.4\text{ m}^2$ ,  
 $S=391.0\text{ m}^2$ - e propozuar;
- Koeficienti i ndërtimit (ISPN) ,sipas Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim” është deri në  $450\text{ m}^2$ ;
- Ndërtesat e banimit, bazuar në Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim”, mund të kenë max. 3 njësi banimi;
- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të komunës së Prishtinës dt.14.08.2016 dhe protokolluar me numrin 04 nr. 031 – 185481, për shkaqe të shfrytëzimit efficient të energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e “termoizolimit”, nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;
- Ngritja e nivelit të përdhësës nga rruga / niveli I terrenit, të jetë  $0.45\text{ m}^2$ ;
- Distanca më e vogël nga parcela fqinje është  $3.0\text{ m}^2$ ;
- Terasat, shakllët e jashtme, ballkonet, konzollat, etj. nuk mund të ndërtohen në distancë më të vogël se  $3.0\text{ m}^2$  nga parcela fqinje;



- Rrethojat kryesisht duhet të jenë transparente apo rrethoja të gjelbra. Baza e rrethojës nuk duhet të jetë më e lartë se 50 cm', mund të jetë nga betoni, tulla apo guri. Pjesa e rrethojës mbi bazë duhet të ndërtohet me materiale të lehta sikur druri, metali apo diçka e ngjashme. Rrethoja përskaaj rrugës ka lartësi prej max.1.5 m' ndërsa në kufi me parcelën fqinjë mund të jetë max 2.0 m';
- Për shtëpitë individuale të banimit, duhet të sigurohet 1 vend parkim, për një njësi banimi; Parkimi i jashtëm mund të planifikohet brenda vijës rregulluese duke respektuar kushtin prej 25% për gjelbërim;
- Në kuadër të parcelës të parashihet hapësira për vendosjen e mbeturinave;
- Arkitektura/dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të efijencës së energjisë, dhe t'i përshtatet destinimit të ndërtesave të planifikuara;
- Zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet ashtu që të jetë në harmoni me projektin arkitektonik dhe uji i strehëve duhet të derdhet brenda parcelës ndërtimore.

**V. Kyçja në Infrastrukturë** - marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina", bëhet me aplikim nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin-adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe çertifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të ndërtesës (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrikë dhe ujë).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos" – Ngrohtorja e Qytetit sh.a dhe PTK.

**VI. Dokumentacioni ndërtimor** – projekti ideor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, "Rregulloren mbi normat minimale teknike për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi" të MMPH nr. 03/2016 dt. 04.11.2016, bazuar në UA nr. 33/2007 për kushtet teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Situacionin – Planin e lokacionit, të gjërë në diametër prej 50 m', me ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin – Planin e lokacionit 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale – kuota të lartësisë, relative dhe absolute;
- Situacionin – "zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale – kuota të lartësisë me pozicionim të ndërtesave në sistem koordinativ Kosova REF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhësë me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Inçizim gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesave të projektuara dhe infrastrukturës rrugore, në sistem koordinativ KOSOVAREF 01;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:50, për ndërtesat e projektuara, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhësë dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Përshkrimin teknik me paramasë dhe parallogari të punëve ndërtimore dhe ndërtimore zejtare;
- Detajet e nevojshme, në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20 she specifikimin e zdrukthëtarisë, me përshkrimin e materialit të dymve dhe dritareve, në përpjesë 1:50;



- Projektin e organizimit të kompleksit, me rrugë, shtigje, mobiliarin urban, etj;
- Projektin e strukturës së ndërtimit – llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionimin dhe detaje të nevojshme;
- Projektin e instalimeve elektro – energjetike, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Projektin e instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Projektin e instalimeve të makinerisë, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetën e qytetit;
- Elaborati i “Organizimi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim”, bazuar në Vendimin 01nr.035-174324 dt.12.07.2016, e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Elaboratin për masat mbrojtëse kundër zjarrit;
- Elaboratin e fizikës ndërtimore dhe atë mbrojtës nga zhurma;
- Elaboratin gjeomekanik, në bazë të analizave të terrenit;

**VII. Paguesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore** – meqenëse parcela kadastrale nr. 02044-1 ZK. Çagllavicë, në bazë të çertifikatës së njësisë kadastrale, është evidentuar me lloj të shfrytëzimit të parcelës – tokë bujqësore, me klasë të kualitetit “Arë e klasës 3” , kërkohet që paraprakisht të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, konform nenit 11,13 dhe 14 të ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8,9 dhe 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë. Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do t’i ndërrohet destinimi, do të regjistrohet si tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore për sipërfaqen prej  $S=541m^2$ .

Ky kompensim – pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e Lejes Ndërtimore.

**VIII. Paguesa e taksës për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës**, do të realizohet sipas “Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01Nr.434/01– 0094474/17 dt.24.04.2017 dhe Rregulloren për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores mbi taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01nr.434/01-227572/23 dt.01.12.2023 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor / projektin ideor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Paguesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të Udhëzimit Administrativ të MMH-së Nr. 06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

Paguesa e taksës administrative do të llogaritet edhe për rrënimin e ndërtimeve ekzistuese në kuadër të parcelës kadastrale, bazuar në gjendjen ekzistuese, incizimin gjeodezik dhe projektin ideor të atyre ndërtimeve, me pagesën e taksës së përcaktuar në pikën 5.9 të nenit 5 të rregullores së lartë cekur dhe vendimit për lejimin e rrënimin, në rastin konkret sipas Certifikatës së njësisë kadastrale dhe incizimit gjeodezik nuk ka ndërtesë në kuadër të parcelës që është subjekt i këtij vendimi.

**IX. Vlefshmëria** e vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore është një (1) vit, me mundësi të vazhdimin për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

## A r s y e t i m

Bashkëpronarët Driton Qehaja dhe Selvete Shuleta Qehaja nga Prishtina, me adresë Rr. Simon Shiroka, 30D/7, me kërkesën 05 Nr. 350/02-32235/24 dt.04.03.2024, kanë kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin ideor për ndërtimin e shtëpisë individuale me etazhitet B+P+1, në kuadër të Parcelës ndërtimore: “L-10-14”, të Bllokut urban “L-10” të Tërësisë “L”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim” në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale 02044-2



ZK. Çagllavicë, lokacioni është përshkruar në paragrafin II. të dispozitivit të këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

Me kërkesën 05 Nr. 350/02-32235/24 dt.04.03.2024 për kushte ndërtimore dhe 05-350/03-149325/24 dt.11.11.2024 plotësim lënde dhe 05-070/01-96793/24 dt.25.07.2024 plotësim lënde, bashkëpronarët kanë prezantuar dokumentacionin, si në vijim:

- *Dëshmia mbi pronësinë, kopjen e planit dhe certifikatën e njërive kadastrale të parcelave nr.00246-2 dhe 00246-3, ZK Çagllavicë lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës me datë 02.10.2023;*
- *Incizimi gjeodezik i Plani i Situacionit- Gjendja Faktike e parcelave kadastrale nr.00246-2 dhe 00246-3, ZK Çagllavicë, punuar nga gjeodeti i licencuar Muzafer Mustafa me numër licence 09;*
- *Informatën nga “Plani Rregullues Prishtina e Re-Zona Perëndim” me referencë 04 – 350/01 – 99897/23 dt. 18.05.2023, lëshuar nga drejtoria e Planifikimit Strategjik e Komunës së Prishtinës;*
- *Fotokopja e letërnjoftimit të pronarëve;*
- *Izet Morina, i autorizuar i Lumnije Morina /pronare e parcelës kadastrale me nr.00246-4, ZK Çagllavicë, me Akt noterial LRP. nr. 4289/2024 dt.28.05.2024, para noter Astrit Bibaj, jep Pëlqimin dhe dakordohen me pronarët Driton Qehaja dhe Selvete Shuleta Qehaja, që riparcelimi sipas Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim”, të dislokohet në kufirin kadastral të parcelës nr.00246-3 dhe 00246-4, ZK Çagllavicë;*
- *Dëshmia mbi pronësinë, kopjen e planit dhe certifikatën e njërive kadastrale të parcelave nr.02044-2 dhe 002044-1, ZK Çagllavicë (produkt i ndarjes dhe bashkimit sipas vijës rregulluese të parcelave nr.00246-3 dhe 00246-4, ZK Çagllavicë), lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës me datë 21.11.2024;*
- *Projektin ideor të ndërtesës së planifikuar në kuadër të parcelës kadastrale në fjalë, të hartuar nga “3Fije”, me hartuese Fiona Beqiri ida;*
- *Fotot e lokacionit.*

Drejtoria e Urbanizmit, pas pranimit të kërkesës për kushte të ndërtimit 05 Nr. 350/02-32235/24 dt.04.03.2024, trajtimit-shqyrtimit të saj, me dokumentacionin e prezantuar me këtë dosje, plotësimin e lëndës me referencat 05-350/03-149325/24 dt.11.11.2024 dhe 05-070/01-96793/24 dt.25.07.2024, konsultimit të lokacionit në fjalë, rregullativës ligjore në fuqi, nga aspekti i planifikimit, ndërtimit dhe procedurës së përgjithshme administrative, konkretisht verifikimit të gjendjes faktike në terren, në mënyrë kronologjike konstatoi zhvillimin e procedurave dhe faktet që kanë quar deri në vendosjen e çështjes administrative, si në vijim:

Aplikuesit, me kërkesën 05 Nr. 350/02-32235/24 dt.04.03.2024, kanë kërkuar nga kjo drejtori caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin ideor për ndërtimin e shtëpisë individuale me etazhitet P+1 fillimisht, pastaj me etazhitet B+P+1, fillimisht në kuadër të parcelës kadastrale me nr.00246-3, ZK Çagllavicë, më pastaj me bashkimin dhe ndarjen e parcelave sipas vijës rregulluese të planit ,formohet parcela ndërtimore nr.02044-1, ZK Çagllavicë, konkretisht në kuadër të Parcelës ndërtimore: “L-10-14”, të Bllokut urban “L-10” të Tërësisë “L”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim” në Prishtinë, miratuar me Vendimin e Komunës së Prishtinës, 01 Nr. 35-186850 dt.02.10.2013, ku sipas këtij plani kjo zonë është paraparë të jetë me destinim rezidencial për banim individual.

Duke u bazuar në nenin 18 të ligjit Nr.04/L-110 për ndërtim, pikën 1,2 dhe 1.2.2 të nenit 1.3 të udhëzimit administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, kjo drejtori me datë 22.04.2024 ka vendosur njoftimin publik në hapësira të dukshme dhe frekuentuese të lokacionit dhe rrethinës në diametër prej 50 m’, për të njoftuar publikun me synimin e pronarit , për ndërtim, dhe i njëjti është lënë në dispozicion të tyre për 5 (pesë) ditë, për t’ju mundësuar të interesuarve paraqitjen e vërejtjeve dhe komenteve. Ky njoftim publik ka vazhdar të qëndroj deri më datën 26.04.2024, dhe gjatë kësaj periudhe kohore, në postën elektronike zyrtare nuk ka arritur asnjë ankesë, kërkesë, vërejtje / sugjerim nga qytetarët e asaj zone.



Në analizën e situacionit nga aspekti i komunikacionit dhe prezantuar në shkresën e zyrtarit – ekspertit për komunikacion, janë përcaktuar masat që duhet të ndërmerren, për kyçje të parcelës në rrugën ekzistuese të lagjes, dhe është konstatuar, si ne vijim:

“Pas shiqimit të propozimit të situacionit të zgjidhjes urbane të Driton Qehaja, në Çagllavicë, lidhur me kërkesën për kushte ndërtimore të lëndës 05 Nr. 350/02-32235/24 dt.04.03.2024, kyçja për automjete në rrugën ekzistuese “Zef Serembe” e cila rrugë është e paraparë edhe me planin rregullues “Prishtina e Re Zona Perëndim”, për ndërtesën banimore me etazhitet B+P+1, të paraparë me këtë zgjidhje urbane, mund të pranohet si e till, marrë parasysh edhe gjendjen faktike të rrugës ekzistuese ne raport me parcelën 02044-1, Zk. Çagllavicë. Kyçja duhet ti përshtatet teknikisht rrugës së planifikuar, dhe të zbatohen kushtet e shikueshmërisë horizontale dhe vertikale në lokacionin e kyçjes.”.

Bazuar në konstatimet e mësipërme dhe dokumentacionin e shqyrtuar, rregullativës ligjore në fuqi, konkretisht nenin 18 të ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenin 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174 dt.31.07.2013, nenin 13 të Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, Drejtoria e Urbanizmit ka konstatuar se kërkuesi ka prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, se plani i situacionit – “Zgjidhja Urbane”, është në harmoni me destinimin dhe kriteret e tjera të planit rregullues urban për atë hapësirë, si dhe në harmoni me rrethinën, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore.

Nga sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

**Shtojcë:** Plani i Situacionit – Zgjidhja urbane, “Situacioni i parcelës me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga Plani Rregullues në sistem koordinativ KosovaREF01” të punuar nga kjo Drejtori.

**Udhëzimi juridik:** Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtyre kushteve ndërtimore. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI, Departamenti Ligjor i MMPHI-së.

**Ky vendim u printua në 4 (katër) kopje identike dhe i dërgohet:** Aplikuesve, në dosje të lëndës, kësaj drejtorie dhe Qendrës për shërbim me qytetarë.

**Kopja elektronike i dërgohet:** Drejtorisë së Kadastrit dhe Drejtorisë së Planifikimit Strategjik.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,  
05NR.350/02 – 32235/24 DT.17.12.2024**

Zyrtare,  
Bahtie Uka



Udhëheqëse e Sektorit,  
Nazife Krasniqi






Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic Of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opstina Pristina - Municipality Of Prishtina



DREJTORIA E URBANIZMIT

SITUACIONI I PARCELAVE ME VIJEN NDERTIMORE DHE  
RREGULLUESE NGA PLANI RREGULLUES NE SISTEMIN  
KOORDINATIV KOSOVAREF01



Punoi:  
Kushtrim Domaneku

Nënshkrimi : \_\_\_\_\_


Prishtinë: 05.09.2024

Legjenda:

- Vija Rregulluese sipas PRRU
- Vija Ndërtimore sipas PRRU
- Parcelat Kadastrale







		Situacioni i gjërë	
PROJEKTI	PRILINDJA	FIGURA	01
Titulli i projektit	Titulli i objektit	Skala	A1
Autori i projektit	Autori i objektit	DATA	11.11.2024
Titulli i autorit	Titulli i objektit	Skala	1:100